

VENDIM
Nr. 429, datë 17.5.2017

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 1719, DATË 17.12.2008, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË ANKANDIT PUBLIK”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 45, të ligjit nr. 9874, datë 14.2.2008, “Për ankandin publik”, të ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në rregullat e ankandit publik, miratuar me vendimin nr. 1719, datë 17.12.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

1. Pas paragrafit të fundit të pikës 4, të kreut IV, “Llojet dhe përzgjedhja e procedurës”, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të ankandit.”.

2. Pas pikës 4.3, të kreut IV, “Llojet dhe përzgjedhja e procedurës”, shtohet pika 4.4, me këtë përmbajtje:

“4.4 Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të ankandit:

a) Kjo procedurë përdoret vetëm në rastet e parashikuara në nenin 20/1, të ligjit nr. 9874, datë 14.2.2008, “Për ankandin publik”, të ndryshuar.

b) Autoriteti shitës përdor procedurën me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të ankandit, për mallrat e konfiskuara dhe të administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, natyra e të cilëve nuk lejon zbatimin e afateve të përcaktuara në nenin 28, të ligjit nr. 9874, datë 14.2.2008, “Për ankandin publik”, të ndryshuar, dhe përcaktimin e çmimit të plotë, në veçanti:

- të shitjes së gjësë së gjallë;

- të shitjes së mallrave të konfiskuara (fruta, perime, bulmet, mish dhe çdo mall i këtij lloji) që ndryshojnë natyrë në një kohë relativisht të shkurtër apo që mund të jenë në prag skadence dhe që është i domosdoshëm tjetërsimi i tyre.

c) Urdhri për ankand, siç parashikohet në kreun V, shkronja “ç”, e pikës 5, e këtyre rregullave, përcakton edhe arsyet e përdorimit të kësaj procedure.

ç) Afati kohor minimal, për dorëzimin e ofertave në këtë procedurë, është 3 ditë nga data në të cilën është dërguar ftesa për ofertë kandidatëve.”.

3. Në shkronjën “c”, të pikës 5.3, të kreut V, “Zhvillimi i procedurave”, pas fjalëve “...10 ditë...”, shtohen fjalët “...ndërsa për procedurën me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të ankandit, nuk duhet të kalojë 3 ditë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi